



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	19.05.2021
Referenc-ë:	07-353/04-82367/21
Për/ Za/ To:	Shkolla e Mesme e Mjekësisë “Rezonanca”
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrëtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorija për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokollit 07-353/04-82367/21 nga Shkolla e Mesme e Mjekësisë “Rezonanca” me të cilën kërkohet që me datë 25 Maj 2021 nga ora 10:00 deri në 15:00 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike, sheshi “Skënderbeu”.

Qëllimi i aktivitetit është ofrimi i shërbimi mjekësor falas për qytetarët si: matja e tensionit, matja e sheqerit, ofrimi i dezinfektuesve si dhe ofrimi i informatave të përgjithshme dhe të nevojshme shëndetësore.

Drejtorija pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Skënderbeu” me datë 25 Maj 2021 nga ora 10: deri në 15:00 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.